



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
“MIRATIMIN E DISA KARAKTERISTIKAVE TEKNIKE TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 20, pika 1, shkronja “g”, dhe 3 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor.

Neni 98, pika 1 ka parashikuar kompetencën e KQZ-së për përgatitjen e fletëve të votimit.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, është hartuar projektvendimin “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Me vendimin nr. 2/2023 Komisioni Rregullator ka miratuar disa karakteristika teknike të fletëve të votimit që do të përdoren për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Neni 97, pika 2 e Kodit Zgjedhor përcakton se, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fleta votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë. Pika 3/1 e këtij neni përcakton që ngjyra e fletës në zgjedhjet e qeverisjes vendore, është e njëjtë në të dyja anët e saj.

Me vendimin nr. 9, datë 1.3.2023, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 2/2023 “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” të Komisionit Rregullator janë ndryshuar kodet e fletës së votimit si vijon: Kodi i ngjyrës së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie është PANTONE 7401 U (ngjyrë e artë). Kodi i ngjyrës së fletës së votimit për kandidatët për anëtarët e këshillit bashkiak është

PANTONE 179 – 2 U (ngjyrë gri).

Propozohen të miratohen edhe disa karakteristika të tjera teknike të fletës së votimit si vijon:

Lloji i letrës:

Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 210 mm

Gjatësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 297 mm

Orientimi i fletës së votimit:

Portret

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës: PANTONE 7401 U

Barkodi (elementë të fshehur teknike në formën e kodeve):

- Numri serial 7 shifra
- Qarku 2 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra dhe elementin

ndarës “/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit

Zona Zgjedhore

Qendra e votimit

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: ..2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

“MIRATIMIN E DISA KARAKTERISTIKAVE TEKNIKE TË FLETËS SË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”

Në mbështetje të nenit 20 pika 1, shkronja “g”, nenit 97, pikat 2 e 3/1 dhe nenit 98, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen brenda afatit ligjor, mund të ndryshohen përmasat e fletëve të votimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar

Data: xx.x.2023 Nr: x
Ora: x:xx



“Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkinë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”

Disa karakteristika të fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023

Lloji i letrës:

Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit jo më e vogël se 210 mm
Gjatësia e fletës së votimit jo më e vogël se 297 mm

Orientimi i fletës së votimit:

Portret

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.
Logo KQZ, me ngjyra.

Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës:

PANTONE 7401 U

Barkodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):

- Numri serial 7 shifra
- Qarku 2 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra dhe elementin ndarës “/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit

Zona Zgjedhore
Qendra e votimit